



Cilat janë produktet që mund të zhduken në Shqipëri si pasojë e ndryshimeve klimatike

Faqe 6

Bagëtitë e juglindjes janë pakësuar, por blegtorët i kanë sytë nga skemat e subvencioneve

Faqe 4

AZHBR: Akuzat për keqpërdorim të fondeve të BE-së, sulme politike të pavërteta

Faqe 3



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit gusht 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 443
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

QEVERIA PËR FERMERËT 1.2 MILIARD LEK MË SHUMË SE SA PROGRAMI I FILLIMVITIT 2022 MBËSHTETJA ME SHITESË TË SUBVENCIONIT ËSHTË NË KOHËN E DUHUR DHE MJAFT DOBIPRURËSE PËR FERMERËT DHE PESHKATARËT

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) vlerëson dhe përshëndet vendimin për rritjen me 2.8 herë të buxhetit të Skemës kombëtare të mbështetjes, si dhe për shtesën me 33 % për fermerët prodhues të drithërave dhe peshkatarët si mjaft dobiprurëse, e alokuar në kohën e duhur, që do të disbursohet përmes një skeme të thjeshtë.

Nga: Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Zgjerohet biznesi i prodhimit të vajrave esenciale Made in Albania



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

AKTUALITET

Agroturizmi rrit interesin për bujqësinë autoktone, banka shqiptare ruan 4500 lloje kultivarësh

Faqe 6



Subvencionim peshkimit, Kristo: Naftë me 40 lekë/litër nga 1 korriku deri më 31 dhjetor

Faqe 2

UBT

Arsimi i lartë Dual në shkencat zooteknike i paraprin modernizimit të blegtorisë në vendin tonë

Prof. Dr. Myqerem Tafaj
Universiteti Bujqësor i Tiranës

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

■ Përgatitja e silazhit misër kalli në fermat e vogla familjare Fq.11-12
Përgatitën: Albi Shehu, Flamur Shabani

■ Kalendari bujqësor, muaji gusht 2022 Fq.13
Nga: Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

BUJQËSI

Ministria e Bujqësisë shpall 38 vende vakante për inspektor veterinar

Faqe 2

RISI ALBANIA

Zgjerohet biznesi i prodhimit të vajrave esenciale Made in Albania

Nisi si një eksperiment në vitin 2010, duke dërguar disa mostra të vajit esencial nga Shqipëria drejt Amerikës. Suksesi ishte i menjëhershëm, mostrat e para u pasuan nga shumë të tjera pas ndërtimit të distilerisë në Tiranë në vitin 2011. Me shpejtësi drejt vitit 2018, kur MEIA po përfundon së ndërtuari një tjetër distilieri në Malësinë e Madhe, pasi ka zgjeruar bazën e furnizimit në Tiranë dhe Sarandë.

Kjo është historia e Emiland Skora, pronar i kompanisë MEIA, Eksport-import Mesdhe-Shqipëri që distilon dhe eksporton vajin esencial prej bimëve aromatike mjekësore shqiptare drejt tregjeve amerikane, evropiane dhe australiane. Sikundër shpjegon ai “e nisëm në 2011 me kontratën e parë dhe tani në 2018 kemi arritur kontrata 10-vjeçare për të eksportuar vajin esencial të bimëve në Amerikë, Kanada, Australi dhe disa vende evropiane. Kjo u bë e mundur falë bashkëpunimit me Risi që besoi tek ne dhe na ndihmoi të zgjeruam kapacitetet përpunuese në vitet e para të aktivitetit tonë”.

Emiland shpjegon se MEIA ka marrëveshje me fermerët shq-

iptarë duke u marë me qira dhe duke u blerë tokën që zotërojnë. Synimi i tij është të bëhet distiluesi i vetëm në Shqipëri që

urt për prodhimin, unë vetë dhe fermerët e zonës kemi rregjistruar biznesin tonë dhe i kryejmë transaksionet përmes bankës”.



zotëron në masën 100% të gjithë këtë sipërmarrje dhe kur t'ja dalë mbanë MEIA do të shndërrohet në fermën më të madhe organike në Shqipëri dhe Ballkan.

Valentin Sterkaj është 28 vjeç dhe punon për distilimin e re në Koplik. Ai grumbullon bimët nga fermerët e zonës dhe gjithashtu furnizon MEIA-n edhe nga toka e tij. Ka rreth 3 vjet që punon me MEIA-n dhe vlerëson sigurinë që kompania ofron për këtë zonë “duke patur një kontratë afatgjatë dhe të sig-

MEIA zotëron 2 distilieri në Tiranë dhe Koplik, 250 HA tokë dhe me qira në Tiranë, Malësi e Madhe, Belsh, Librazhd, Lushnjë dhe Sarandë ka thuhajse 300 HA të mjella kryesisht me Lavandër, Helikrisium, Melissa dhe Kamomil.

Më tej? Veç tregjeve të reja, Emiland na zbulon se e bashkëshortja e tij po eksploron mundësinë e detergjentëve bio me ujin që vjen nga procesi i distilimit.

Saga vazhdon...

Mbështetje nga IPARD në teknologji të reja, kompania e bimëve mjekësore rrit eksportet në SHBA

Sipërmarrjet në fushën e bimëve mjekësore dhe aroma-

transformim sa i takon zhvillimit të kompanisë”, shkruan Krifca.

e punës, por ka rritur performancën, rendimentin e prodhimit, rritjen e eksporteve si dhe cilësinë e produktit”.

Petrit Skora, administrator i kompanisë “Meia” merret me prodhimin e esencave vajore nga bimët aromatike të cilat eksportohen kryesisht në SHBA.

Skora tregon disa nga proceset e përpunimit të bimëve aromatike që kryhen në kompaninë e tij, teksa vlerëson investimet në pajisje të reja dhe teknologji bashkëkohore falë mbështetjes nga IPARD, si faktor kryesor në arritjen e rezultateve pozitive të prodhimit.

“Kompania jonë prodhon rreth 200 tonë esenca në 24 orë e cila ambalazhohet dhe tregohet sipas kontratave të parënshkruara”, tha Skora.



tike, falë mbështetjes edhe nga programet e qeverisë dhe BE-së, po zhvillohen duke arritur rezultate konkrete në prodhimin, eksportin dhe rritjen e atë ardhurave në ekonominë e tyre.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca publikoi në rrjetet sociale shembullin e një biznesi që operon në këtë fushë, që falë mbështetjes nga programi IPARD, ka implementuar teknologji të reja, duke lehtësuar proceset e përpunimit dhe rritur rendimentin.

“Një kompani e orientuar drejt bimëve medicinale, e cila edhe falë mbështetjes së programit IPARD, ka përjetuar një

PUNËSIM

Ministria e Bujqësisë shpall 38 vende vakante për inspektor veterinar

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka shpall 38 vende vakante për inspektor veterinar në tre qytete të vendit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, u shpreh se “jemi në proces rekrutimi për të zgjeruar trupën tonë të veterinerëve zyrtarë të shërbimit”.

Sipas saj, duke plotësuar strukturën e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve e çojmë numrin e veterinerëve zyrtarë të shërbimit dhe veterinerëve të kontrollit në 453 në të gjithë territorin.

“Bëhuni pjesë e ekipit tonë



në Elbasan, Shkodër apo Vlorë deri më 26 Gusht”, shkroi duke shprehur interesin tuaj Krifca në rrjetet sociale.

NJOFTIM PËR SHPALLJE TË VENDEVE VAKANTE

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve shpall njoftimin për vende të lira pune për Veterinerë Zyrtarë Shërbimi në Rajonet:

Elbasan (11 pozicione)	Shkodër (15 pozicione)	Vlorë (12 pozicione)
----------------------------------	----------------------------------	--------------------------------

Për më tepër informacion vizitoni www.akvmb.gov.al
Afati i aplikimit: 26.08.2022

Subvencionim peshkimit, Kristo: Naftë me 40 lekë/litr nga 1 korriku deri më 31 dhjetor

Qeveria mbështet peshkarët të përfitojnë naftë me kosto të ulët në 40 lekë/litr për anijet e peshkimit, për të përballuar rritjen e madhe të çmimit të naftës dhe kostot e peshkimit.

Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Roland Kristo shkroi në Twitter, se “ka hyrë në fuqi udhëzimi i datës 01/08/2022, i cili ndër të tjera përcakton edhe procedurën dhe dokumentacionin për mbështetjen për naftën e peshkimit me 40 lekë/litr”.

“Mbështetja përfshin periudhën 01/07/2022 deri 31/12/2022”, shkruan Kristo, teksa publikoi udhëzimin që sqaron kriteret dhe procedurat që duhet të plotësojnë peshkatarët

për të përfutur nga mbështetja financiare e qeverisë.

Në mbledhjen e fundit qeveria miratoi një fond shtesë prej 200 milionë lekësh për subvencionimin e naftës për peshkim.

Nga ky fond, do të përfi-

tojnë me 40 lekë për litër subvencion shtesë për naftën 203 anije peshkimi në vend. Kjo mbështetje ndikon në rreth 5 milionë litra naftë që konsumohet nga anijet e peshkimit deri në fund të vitit.



SKEMA KOMBËTARE

QEVERIA PËR FERMERËT 1.2 MILIARD LEK MË SHUMË SE SA PROGRAMI I FILLIMVITIT 2022

MBËSHTETJA ME SHITESË TË SUBVENCIONIT ËSHTË NË KOHËN E DUHUR DHE MJAFT DOBIPRURËSE PËR FERMERËT DHE PESHKATARËT

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) vlerëson dhe përshëndet vendimin për rritjen me 2.8 herë të buxhetit të Skemës kombëtare të mbështetjes, si dhe për shtesën me 33 % për fermerët prodhues të drithërave dhe peshkatarët si mjaft dobiprurëse, e alokuar në kohën e duhur, që do të disbursohet përmes një skeme të thjeshtë.

Nga: Agim Rrapaj
Kryetar i Këshillit
të Agrobiznesit Shqiptar

Subvencioni përmes Skemës Kombëtare të mbështetjes për fermerëve prodhues të drithërave dhe peshkatarëve rritet edhe me 1.2 miliard lek ose 33 % më shumë se sa program i fillimvitit 2022. Është mbështetja më e madhe ndër vite me grant nga buxheti për bujqësinë dhe peshkimin, e cila nga 1.78 miliard lekë në vitin 2021 arriti në 4.9 miliard lekë në vitin 2022 ose 2.8 herë më shumë.

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) vlerëson dhe përshëndet vendimin për rritjen me 2.8 herë të buxhetit të Skemës kombëtare të mbështetjes, si dhe për shtesën me 33 % për fermerët prodhues të drithërave dhe peshkatarët si mjaft dobiprurëse, e alokuar në kohën e duhur, që do të disbursohet përmes një skeme të thjeshtë, të mundshme dhe transparente për përfituesit.

Fermerët prodhues të grurit e vlerësojnë pozitivisht mbështetjen me 30 mijë lekë/ha sepse u garantohet falas plehërimi bazë i tokës që do të mbjellin me grurë. Gjithashtu shtimi i subvencionit për naf-

tën pa taksa për fermerët edhe me 500 milion lekë të tjerë do të ndikojë në reduktimin e kostos së punimeve të mekanizuara të tokës dhe procesin e mbjelljes së grurit. Mbështetja në kohën e duhur me subvencionin për njësi dhe me naftën falas nxit iniciativën e fermerëve, inkurajon dhe rrit besimin e tyre, për të shtuar sipërfaqen e mbjellë me grurë, për të rritur rendimentin dhe ulur kostot në sezonin që po vjen.

Çmimet e larta të naftës i detyruan peshkatarët të kufizonin ndjeshëm aktivitetin e tyre të prodhimit dhe zënies së peshkut. Mbështetja shtesë e dhënë për rimbursimin e çmimit të naftës me 40lek/litër duke filuar që nga 1 korriku 2022 ishte shumë e nevojshme dhe në kohën e duhur. Peshkatarët tashmë do të vijnë intensivisht veprimtarinë e tyre të prodhimit, zënies, përpunimit dhe eksportit të peshkut.

Skema e zbatimit për disburimin e fondeve grant është e thjeshtë, e kuptueshme për aplikuesit, nuk ka limitet kohore të aplikimit, si dhe vështirësi e pengesa që nuk mund të kapërcehen nga aplikuesit. Ajo garanton transparencë në disburim, që është shumë e nevojshme dhe domosdoshmëri për vijimësinë e alokimit

të më shumë fondeve grant nga buxheti, për të gjithë sektorët e Ekonomisë Ushqimit në Shqipëri.

Informimi për veprimtarinë, investimet dhe çdo masë tjetër që merret për të rritur besimin e fermerëve dhe peshkatarëve, për të garantuar eficientë e aktivitetit të tyre prodhues dhe jo vetëm është tejet dobiprurës për të ardhmen në këtë periudhë tejet të vështirë që po kalojmë. Fermerët dhe peshkatarët më shumë se kurdoherë sot kanë nevojë të informohen për konjunkturën dhe pritshmëritë e çmimeve të blerjes së inputeve, konjunkturën e tregjeve dhe çmimet e shitjes së produkteve të tyre, programet e mbështetjes me subvencione nga buxheti dhe donatorët etj.

Grupimi i fermerëve të formalizuar, pavarësisht nga numri i tyre i kufizuar, në bashkëpunim me qendrat e grumbullimit dhe subjektet e agropërpunimit, të agroturizmit dhe ato të ushqimit social, kur janë kooperuar dhe koordinuar si duhet midis tyre ia kanë dalë të përballojnë vështirësitë me pasoja negative më të reduktuara. KASH ka nxitur dhe përkrahur procesin e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit për dobinë e konsolidimit të kooperimit dhe koordinimit midis aktorëve të

mësipërm. Fillimi i punës për një bursë të disa prodhimeve bujqësore, mbështetje për lidhje kontratash e marrëveshjes paraprake, nxitje procesit të bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe ndihmës reciproke janë disa nga instrumentet më dobiprurëse në këtë situatë tejet anormale që po kalojmë. Mo-



himi i punës dhe arritjeve të fermerëve dhe subjekteve të këtij grupimi, kritikën shpesh pa vend, si dhe nxirja e realitetit për çfarëdolloj arsye qoftë, çënon rëndë besimin për të ardhmen, dekurajon guximtarët dhe minon veprimtarinë dobiprurëse të subjekteve që me shumë sakrifica po prodhojnë ushqimet dhe na garantojnë stabilitetin e vendit.

Por veprimtaria dhe punët nuk po ecin me ritmin që kërkon situata në të cilën ndodhemi për grupimin e fermerëve të paformalizuar, që për fat të keq janë akoma të shumtë në numër. Problemet e këtij grupimi kanë qenë dhe do të vijnë të jenë të shumta dhe të vështira për t'u zgjidhur. KASH për

këtë grupim ka arritur në konkluzion se nuk duhet lënë jashtë vëmendjes dhe mbështetjes siç është lënë deri tani. Zgjidhja që kanë gjetur vetë fermerët e këtij grupimi përmes emigrimit duke braktisur tokën, investimet dhe pasurinë e bërë ndër vite me shumë mund e sakrifica nuk është zgjidhja e duhur. Emigrimi është një proces që nuk do të ndalet, por braktisja

e tokës, lënia e saj djerrë, braktisja e investimeve në pemëtarë, vreshtari, stalla blegtorie, banesa dhe pasuri të tjera u duhen vënë disa barrikada për ta kontrolluar procesin sa nuk është tepër vonë. Shqipëria ka tokë bujqësore /banorë më pak se çdo vend tjetër në Europë ku duam të shkojmë. Këtë pasuri e kanë në pronësi apo e administrojnë 80 % e fermerëve të paformalizuar. Pa përfshirë këtu kullotat, pyjet, livadhet, burimet ujore etj. Sa më vonë të kujtohem për të mbështetur këtë grupim që të formalizohet dhe t'i bashkohet grupimit të parë aq më shtrenjtë do ta paguajmë gabimin. Pavarësisht se këta janë subjekte në mbijetesë duhen mbështetur sepse vendosin për eficientë dhe dobinë e rreth 80 % të tokës bujqësore dhe jo vetëm.

KASH prej vitesh ka propozuar një paketë masash për mënyrën dhe format e mbështetjes së këtij grupimi, por veprimet konkrete për realizimin e masave të propozuara kanë qenë sporadike, të pakoordinuara, jo efiente e dobiprurëse, si për fermerët dhe për shoqërinë. Jemi vonë duhet reflektuar për këtë grupim pa humbur asnjë minutë më shumë.

AZHBR: Akuzat për keqpërdorim të fondeve të BE-së, sulme politike të pavërteta

Agjencia për Zhvillim Bujqësor e Rural i cilësoi sot të pavërteta dhe sulme politike akuzat e ngritura ndaj saj për keqpërdorim të fondeve të Bashkimit Evropian.

AZHBR informoi opinionin publik mbi “akuzat e pavërteta të subjekteve politike që synojnë të përbaltin punën e rëndësishme që është kryer nga AZHBR në vitet e fundit e cila ka kontribuar cilësisht dhe qenësisht për zhvillimin e bujqësisë shqiptare, modernizimin e saj dhe rritjen e punësimit në sektor”.

Sipas agjencisë, “alibia e papërgjegjshme e ngritur si një sulm politik mbi administrimin e AZHBR dhe ‘keqpërdorimin e fondeve të Bashkimit Evropian’ është pa asnjë bazë, e pavërtetë dhe e dënueshme”.

Në emër të transparencës totale, AZHBR thekson se në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues në zbatim të plotë të procedurave të parashikuara nga Programi IPARD II, për

mbi Programin në mënyrë që të rritet mundësia për aplikime të suksesshme.

“Është hartuar Udhëzuesi për Aplikantët i cili është bërë publik së bashku me dokumen-

likën e Shqipërisë ku në transparencë të plotë janë informuar aplikantët. Në transparencë të plotë, fushatat informuese janë kryer edhe nëpërmjet medias së shkruar dhe audiovizive. Është



tet standarde të aplikimit, dhe janë kryer fushatat informuese në të gjitha qarqet në Repub-

informuar publiku vazhdimisht mbi projektet e realizuara”, thuhet në njoftim.

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve, AZHBR shprehet se “ka marrë të gjitha masat për të zbatuar në transparencë të plotë Programin IPARD II, mbi parimin e trajtimit të barabartë të çdo aplikimi në respekt të procedurave standarde të akredituara”.

“Në zbatim të manualit të procedurave dhe Udhëzuesit për Aplikantët, AZHBR shqyrton dhe verifikon gjendjen ligjore dhe financiare të subjekteve aplikantë duke kërkuar dokumente qartësisht të përcaktuara për të gjithë aplikantët njëjloj pa asnjë trajtim të diferencuar.

Kryen verifikimin e pastërtisë së figurës së aplikantit nëpërmjet dokumenteve si: vërtetimin nga Ministria e Drejtësisë që aplikanti nuk ka qenë i dënuar më parë; vërtetimin nga Prokuroria që aplikanti nuk

është në hetim. Kryen verifikimin financiar nëpërmjet dokumentave si: Pasqyra e të ardhurave; licenca për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore; libra inventarësh për të gjithë pasuritë fikse të zotëruara nga subjektet; dokument nga Banka e Shqipërisë për të verifikuar se subjektet aplikante nuk janë kredimarrës të këqij”, thuhet në njoftim.

Bazuar në Udhëzuesin për aplikantë, AZHBR thekson se “çdo projekt verifikohet dhe përjashtohet nga granti vetëm nëse: janë të falimentuar ose në proces likuidimi, nëse aktiviteti i tyre administrohet nga gjykata, nëse kanë hyrë në marrëveshje me kreditorët, nëse kanë pezulluar veprimtarinë ekonomike apo nëse janë në proces gjyqësor lidhur me të tilla çështje”.

“Po ashtu nëse: janë dënuar për një kundërvajtje lidhur me sjelljen e tyre profesionale nga

një vendim gjyqësor i formës së prerë; nuk kanë përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose pagesën e taksave; janë gjykuar me vendim Gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale apo çfarëdolloj veprimtarie tjetër të pa ligjshme që dëmton interesat financiare të BE-së; janë aktualisht subjekt i një gjobe administrative të përmendur në nenin 96 (1) të Rregullores Financiare”, thuhet në njoftim.

Në kushtet kur projekti nuk kategorizohet në asnjë nga pikat e sipërpërmendura, AZHBR shprehet se nuk ka kompetencë investigimi apo hetimi të proceseve por të konfirmojë bazuar në dokumentacionin provues nga institucionet kompetente.

“Subjektet e përmendura i janë nënshtruar verifikimit të plotë mbi statusin juridik, dëshmi penaliteti, vërtetimin nga prokuroria/gjykata që nuk

TEMA TË DITËS

Dhe me këtë lajm të mirë për bujqësinë shqiptare, ju uroj një javë të mbarë

Qeveria Rama rrit financimin për bujqësinë

me **1.2 miliardë** lekë, duke e çuar skemën e mbështetjes ndaj bujqësisë për vitin 2022 në **4.9 miliard** lekë.



Shtojmë me 500 milionë lekë skemën e mbështetjes me naftë për fermerët duke zgjeruar bazën e fermerëve përfitues.



Shtojmë me 500 milionë lekë një masë të re në skemën e mbështetjes për stimulimin e prodhimit të kulturës së grurit për mbjelljet e reja duke financuar 30,000 leke/ha.



Shtojmë me 200 milionë lekë fondin duke mbështetur peshkatarët me 40 lekë për litër naftë për të reduktuar kostot e prodhimit/nxënies dhe stimuluar peshkimin më tej.

Kjo është mbështetja më e madhe e dhënë në ndihmë të bujqësisë dhe prodhimit bujqësor.
#PunëJoLlafe

Bagëtitë e juglindjes janë pakësuar, por blegtorët i kanë sytë nga skemat e subvencioneve

Vitin e fundit në qarkun e Korçës numri i krerëve të gjedhit dhe bagëtive të imta është ulur me 23 mijë

Emigracioni është faktori kryesor i cili ka bërë që të ketë më pak familje që merren me sektorin e blegtorisë e për rrjedhojë të ketë rënie deri në 10 % të numrit të krerëve çka reflektohet në më pak prodhim.

Por ndërsa ka më pak familje që merren me rritjen dhe shtimin e gjedhit apo të imtave interesi po rritet nga skemat mbështetëse për tufat dhe fermerët potenciale çka pritet që të kompensojë diferencën e krijuar.

Ndryshe ka ndodhur me sektorin e bletarisë i cili sipas të dhënave ka pësuar rritje të



konsiderueshme sidomos në 2 vitet e fundit.

Numri i koshereve është

shtuar në masën 100% kjo edhe për shkak të përfitimeve me të mëdha që jep shitja e mjalitit.



AZHBR: Akuzat për keqpërdorim të fondeve të BE-së, sulme politike të pavërteta

(Vijon nga faqja 3)

është subjekt nën hetim, si dhe kanë depozituar dokumentet që vërtetimin posedimin e ligjshëm të tokës objekt aplikimi, në përputhje me kriteret e aplikimit të cilat janë të njëjta për të gjithë. Të gjithë këto dokumente janë kërkuar për subjektet që përmenden në media dhe janë konform rregullave dhe kërkesave të akredituara”, thuhet më tej.

AZHBR sjell në vëmendje se është një institucion i akred-

ituat nga Bashkimi Evropian dhe i monitoruar përmes filtrave të kontrolleve të brendshme e të jashtme nga disa institucione për respektimin dhe zbatimin me përpikmëri të kriterëve të programit, politikave bujqësore dhe akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara në zbatim të tyre.

“Transparenca është parimi kryesor i punës sonë dhe informacioni i plotë për çdo aplikim gjendet në faqen www.azhbr.gov.al. Çdokush që kontakton Agjencinë merr përgjigje shter-

uese me shpresë, email apo përmes numrit të gjelbër. Deklaratat e bëra ditët e fundit në media janë baltë e hedhur mbi AZHBR, për interesa politike dhe personale të individëve që i bëjnë ato, krejtësisht të pavërteta. Këto abuzime me tendencë nuk do të arrijnë të përbaltin kurrë punën intensive dhe me dedikim të 250 punonjësve të cilët kanë arritur ta kthejnë AZHBR në një institucion model në vend për efektivitet dhe transparencë”, thuhet në njoftim.

FOKUS - BE shqyrton rrugë alternative për eksportet e grurit ukrainas

Pavarësisht rifillimit të eksporteve të grurit nga portet e Detit të Zi, sipas një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga OKB-ja dhe Turqia midis Rusisë dhe Ukrainës, BE synon të vazhdojë përpjekjet e saj për të krijuar rrugë alternative mallrash për eksportet e grurit ukrainas.

“Pavarësisht rihapjes së rrugëve detare, një kthim i menjëhershëm në nivelet e paraluftës të eksporteve të Ukrainës mbetet sfidues dhe rrugët alternative të eksportit janë ende vendimtare”, tha një zrytar i Komisionit të BE-së.

Komisionerja evropiane për Transportin, Adina Vaelean theksoi se kishte hapësirë për përmirësime, por vuri në dukje edhe mungesën e vagonëve të mallrave, shoferëve të mauneve dhe objekteve të magazinimit për prodhimet ukrainase.

Sipas Komisionit Evropian, Ukraina ishte eksportuesja

më e madhe në botë i vajit të lulediellit, eksportuesja e tretë më e madhe e elbit, eksportuesja e katërt më e madhe e misrit dhe eksportuesja e pestë më e madhe e grurit përpara fillimit

son rifillimin e eksporteve të rregullta bujqësore ukrainase nëpërmjet Detit të Zi.

Sipas shifrave të BE-së, para luftës, deri në pesë milionë tonë drithë kalonin çdo



të pushtimit të Ukrainës nga trupat ruse.

Megjithatë, shpresat aktualisht janë të lidhura me marrëveshjen me Rusinë që mundë-

muaj nëpër portet e Detit të Zi.

Arritja e këtij niveli përsëri në të ardhmen e afërt konsiderohet e pamundur.


Rimbursimi i fermerëve, kreu i agrobiznesit në Report Tv: Hap me rëndësi! Nuk do ketë mungesë produktesh, por rritje çmimesh

Prej datës 1 shtator të gjithë fermerët që kultivojnë grurë do të kenë mundësinë që të aplikojnë online pranë AZHBR-së për të përfituar rimbursimin prej 30 mijë lekësh për çdo hektar grurë që ka mbjellë. Lidhur me këtë njoftim, i ftuar në Report Tv Kryetari i Këshilli të Agrobiznesit shqiptar Agim Rrapaj

Prej datës 1 shtator të gjithë fermerët që kultivojnë grurë do të kenë mundësinë që të aplikojnë online pranë AZHBR-së për të përfituar rimbursimin prej 30 mijë lekësh për çdo

për mbi 60 nga kemi kosto të kënaqshme. Dhe këto e ekuilibrojnë prodhimin e grurit. S'të jap dot shifër mesatare se varion nga parcela në parcelë. Është një proces i gjatë, ka di-

nuk do të kemi mungesa. Për qumështin duhet parë një zgjidhje afatgjatë, për blegtorinë ne duhet të tregojmë shumë vëmendje sepse është rritur kostoja tejet limiteve. Ne duhet të mendojmë për frenimin e uljes së konsumit. Qeveria duhet të mendojë për këto masa. Mund të ketë rritje çmimi por nuk do të ketë mungesë të asnjë produkti. Po nuk ka rëndësi për aq sa kohë nuk e blen dot, se do rriten çmimet.”- tha Rrapaj



hektar grurë që ka mbjellë. Lidhur me këtë njoftim, i ftuar në Report Tv Kryetari i Këshilli të Agrobiznesit shqiptar Agim Rrapaj.

Ai e ka cilësuar si një ndërhyrje të shpejtë dhe në kohën e duhur.

“Është një ndërhyrje në kohën e duhur në momentin e duhur. Kjo është një risi, kushdo që kultivon mbi 1000 hektarë ai përfiton dhe kjo është e rëndësishme”- tha Rrapaj në Report Tv

Pyetje: Sa janë shifrat mesatare të përfitimi?

“Varet ku mbillet, psh

namikën e vet”- u shpreh ai.

I pyetur për procedurën Rrapaj u shpreh se nuk do të ketë asnjë vështirësi për fermerët dhe se transparenca është mjaft e rëndësishme për kapërcimin e tij.

“Nuk ka vështirësi të pakapërcyeshme në këtë uzinë. Transparenca është shumë e rëndësishme.”

Rrapaj sqaroi në Report Tv, tha se nuk do të ketë mungesë të produkteve por do të ketë rritje çmimi.

“Nuk do ketë mungesë të drithërave në Shqipëri, kemi kapacitetet e duhura. perimet

Aplikimet për këtë skemë do të qëndrojnë të hapura deri në 23 shtator dhe të gjithë fermerët që do të aplikojnë duhet të jenë aktiv me NIPT, të kenë dokumentin që vërteton se kanë tokën në pronësi, në përdorim ose me qira, si dhe duhet të kenë të ruajtura faturat e fiskalizuar të farës së blerë dhe plehrave kimike.

Përfitues do të jenë ata fermerë që do të mbjellin e kultivojnë grurë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa pagesa do të bëhet pas verifikimit në terren të sipërfaqes së mbjellë. Të parët që do të marrin mbështetjen financiare do të jenë ata fermerë që kanë më shumë sipërfaqe të mbjellë, e deri të sipërfaqja më e vogël. Nëse ka fermer me të njëjtën sipërfaqe të mbjell, subvencionin e merr fillimisht ai që ka aplikuar i pari.

INFORMACIONE

Marrëveshja me Italinë, përfitues edhe ata që e kanë mbushur moshën e pensionit

Falë marrëveshjes që qeveria shqiptare ka nënshkruar së fundmi me Italinë, çdo shtetas shqiptar që ka punuar në vendin fqinj, do të marrë pension edhe në Shqipëri.

Astrit Hado, drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, thotë se marrëveshja reciproke bashkon vitet e kontributeve në të dy vendet dhe qytetari merr dy pensione të ndryshme në të dyja shtetet.

Në një intervistë televizive, Hado tha se, “marrëveshja parashikon bashkimin e periudhave të kontributeve, që do të thotë, vetëm për të plotësuar kriteret ligjore, në kemi 15 vjet sigurime dhe Italia ka 20 vjet sigurim, do të konsiderohen periudhat e kontributeve të realizuara në Itali njëloj sikur janë bërë në Shqipëri, që do të thotë vetëm për të kualifikuar. Ne do ia paguajmë në llogarinë e vet, IMSI-it italian, që është homologu i ISSH-së, do i paguajë në llogarinë e vet. Do marrin dy pensione”.



I pyetur se çfarë ndodh me një shtetas shqiptar i cili ka punuar 10 vite në Itali dhe 10 vite në Shqipëri, duke mos i plotësuar vitet e punës për shteteve, Hado shpjegoi se, “bashkimi i periudhave i fut në kushte të dy skemat. Në marrëveshje është thënë që e drejta për të përfutur është nga momenti që hyn marrëveshja në fuqi, por ky është momenti që do të merren lekët, por nuk do

të thotë që nëse një qytetar shqiptar ka dalë në pension në Itali në 2015, nuk do i marrë lekët në 2015, por do i marrë në momentin që do të hyjë marrëveshja në fuqi”.

Janë afro 700 mijë shtetas shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Itali të cilët përfitojnë nga marrëveshja reciproke për pensionet.

Ndërsa 2 mijë kompani italiane operojnë në Shqipëri në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Hyn në fuqi marrëveshja për sigurimet shoqërore me Kanadanë, 40 mijë përfitues

Nis zbatimi i marrëveshjes për sigurimet shoqërore me Kanadanë, ku përfitojnë rreth 30-40 mijë shqiptarë, të cilët jetojnë dhe punojnë në këtë vend.

Lajmin e bëri të ditur ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, e cila përmes një postimi në rrjetet sociale theksoi se, rreth 30-40 mijë shqiptarë të cilët jetojnë dhe punojnë në Kanada pritet të përfitojnë nga marrëveshja për sigurimet shoqërore me këtë vend.

“Kjo marrëveshje e ratifikuar në vitin 2019 synon trajtimin e barabartë të qytetarëve dhe njohjen e periudhave të vjetërsisë në punë”, tha Ibrahimaj.

Marrëveshja me Kanadanë vjen pas njohjes së sigurimeve shoqërore me Italinë, ndërsa Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka nënshkruar deri tani



rreth 11 marrëveshje me shtete të ndryshme të BE-së dhe jo vetëm, për njohjen e periud-

have të vjetërsisë në punë të shqiptarëve që punojnë në këto vende.

Peskaturizmi, diversifikim i ofertës turistike

Turizmi i peshkimit synon të kthehet në një praktikë të qëndrueshme të turizmit detar.

Peskaturizmi (kombinimi i turizmit me peshkimin), po shihet si një ofertë e re, që do t’i ofrohet vizitorëve vendas dhe të huaj, me qëllim rritjen e të ardhurave për peshkatarët artizanale.

Iniciativa “Promovimi i Peskaturizmit në zonat e mbrojtura detare/bregdetare të Shqipërisë”, financuar nga UNDP Albania, është duke u zbatuar nga kompania e konsulencës në bashkëpunim



me institucionet e linjës në Parkun Kombëtar Divjakë-

(Vijon në faqen 10)

Një ligj transformues mbi energjinë e pastër

Nga Enio Jaço
President i Dhomës Amerikane

Një projekt-ligj i ri Klimaterik në SHBA, do transformojë prodhimin e Energjisë dhe Makinave. Me Efekte në gjithë Botën, Konsumatorët, Bizneset dhe Mjedisi do të jenë përfituesit kryesorë.

Senati amerikan po bëhet gati të propozojë një marrëveshje prej 369 Miliardë dollarësh që do të transformonte mënyrën se si prodhohet energjia dhe funksionon industria e automobilave.

Nëse ai bëhet ligj, ai do të ofrojë stimuj të fuqishëm për industrinë e energjisë së pastër,

Ka incenstiva në cash për të ndihmuar konsumatorët të paguajnë për panelet diellore në çati, për karikuesit e automjeteve elektrike dhe për pompat e nxehtësisë me efikasitet të karburantit. Stimujt shtrihen tek prodhuesit e industrisë së energjisë së pastër si dhe tek konsumatorët që do blejnë drejtpërdrejt.

MAKINA ELEKTRIKE MË TË MUNDSHME

Një konsumator mund të marrë deri në \$7,500 kreditim tatimor nëse blen një automjet të ri elektrik.

Por krediti vlen edhe për makinat e përdorura. Për herë



do të përshpejtojë tranzicionin nga karburantet fosile dhe do të japë mësim se si të liberalizohen tregjet e energjisë në vende më të vogla si Shqipëria.

Legjislacioni i ri vjen në një kohë kur ngrohja globale – nga fatkeqësitë e motit deri te temperaturat jashtëzakonisht të nxehta – po ndihet seriozisht në mbarë botën.

Propozimi synon të luftojë njëkohësisht ndryshimet klimatike dhe të aktivizojë prodhimin e energjise se gjelber. Risia e projektligjit është se ai synon të luftojë ndryshimin e klimës përmes stimujve dhe lehtësimit të taksave dhe jo ndëshkimeve, një qasje që bota e biznesit do ta mirëpresë.

Legjislacioni ofron stimuj të rëndësishëm në para drejtpërsëdrejti për konsumatorët – blerësit e automjeteve elektrike, paneleve diellore etj – së bashku me miliarda dollarë për industrinë si prodhuesit e automjeteve, prodhuesit e baterive dhe furnitorët për të ndërtuar ose riorganizuar fabrika.

të parë, makinat e përdorura me bateri do të kualifikohen për një ulje tatimore deri në \$4,000 dollarë. Kjo është e rëndësishme sepse shumica e njerëzve blejnë makina të përdorura, jo të reja.

MBËSHTETJE PËR ENERGJINË E RINOVUESHME

Projektligji synon të përshpejtojë përpjekjet për të kaluar në burime më të pastra të energjisë dhe zhvillimin e teknologjive të reja për të lehtësuar barrën e çmimeve të larta mbi konsumatorët.

Deri në 80% të SHBA-së ose 103 milionë familje do të kursenin para çdo muaj, gjithsej 37 miliardë dollarë në vit, vetëm duke kaluar në furrat elektrike dhe ngrohësit e ujit, të cilat do të kualifikoheshin për lehtësira të reja tatimore sipas faturës së klimës.

Stimujt për familjet, industrinë dhe mjedisin, do jenë të ndjeshme thonë ekspertët. Kreditet fiskale shihen si një nga mënyrat më pak të shtren-

jta për të reduktuar emetimet e karbonit. Përfitimet janë katërfishi i kostos së tyre, sipas llogaritjeve nga Instituti i Politikave të Energjisë në Universitetin e Çikagos.

PASOJAT E POLITIKËS NË TË GJITHË BOTËN

Legjislacioni i ri do të ushtrojë presion ndaj politikëbërësve në mbarë botën për të përqafuar standarde më agresive të energjisë së rinovueshme.

Vende si Shqipëria do të duhet të përshpejtojnë reformën për të liberalizuar tregjet e energjisë, duke vendosur të gjithë furnizimin me energji në shkëmbimet rajonale të energjisë. Kjo do të kishte përfitimet e uljes së çmimeve të energjisë për konsumatorët shqiptarë – veçanërisht në dritën e luftës në Ukrainë.

Por Shqipëria duhet të liberalizojë edhe grumbullimin e burimeve të pastra të energjisë duke lidhur konsumatorët dhe bizneset e vogla me rrjetin kryesor shtetëror elektrik. Kjo do të rriste furnizimin me energji në dispozicion dhe do të ulte çmimet e përgjithshme të energjisë.

Shqipëria duhet të sigurojë gjithashtu kredi tatimore direkte për konsumatorët dhe bizneset e vogla për adoptimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Qeveria duhet t’i japë përparësi programeve të tilla si BERZH dhe IFC – që janë aktive në zonën rajonale të Ballkanit Perëndimor – por që nuk janë ende të disponueshme në Shqipëri.

Legjislacioni për Energjinë e Pastër po bëhet realitet. Në dritën e luftës në Ukrainë dhe rritjes së inflacionit, vendet do të kenë një avantazh të trefishtë për të vepruar: të ulin çmimet e energjisë konsumatore, të kursejnë mjedisin dhe t’i kalojnë disa kredi konsumatorit dhe bizneseve për modernizimin e prodhimit.

Politikëbërësit duhet të veprojnë tani, jo vetëm për të përmbushur detyrimet e tyre mjedisore ndërkombëtare, por më e rëndësishmja për të mbrojtur konsumatorët nga rreziqet e inflacionit.

Korçë, tregu i ri blegtoral me kushte dinjitoze dhe shërbim veterinar

Në Korçë është ndërtuar tregu i ri i blegtoral me standardet më të mira për sa i takon kushteve dinjitoze të tregëtimit të gjëse së gjallë dhe natyrisht sigurisë të plotë ushqimore për konsumatorët.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale, pamje nga ky treg ku shihet transformimi rrënjësor i tij, sipas standardeve më të mira pas investimit të realizuar.

“Ky është tregu i ri i gjëse së gjallë në Korçë, i transfor-



muar në kuadër të programit kombëtar të kalimit nga thertoret e pazaret mesjetare, në modele të standardeve të BE, me shërbimin veterinar, kushte dinjitoze tregëtimit me natyrisht siguri të plotë ushqimore për konsumatorët”, shkruan Rama.

Kryeministri u shpreh se puna vijon edhe për fazën e dytë të investimit në përmirësimin edhe më tej të infrastrukturës së këtij tregu.

AKTUALITET

Koha e mjaltit - Momenti më i rëndësishëm i punës së një bletërritësi

Në Elbasan, Rifan Bashën e njohin të gjithë si mjeshtër të bletëve. Ai thotë se ka më shumë se gjysmë shekulli që mbarështron bletë, dikur bleta për ishte vetëm pasion, por kur pa që mjalti, propolisi dhe qumështi i bletës i siguronin atij të ardhura të kënaqshme, vendosi që pasionin ta shndërronte në profesion.

“Me bletët kam 50 vite që merëm. E kam të trashëguar nga gjyshi i nënës. Pas viteve të demonstracisë e kam kthyer në pasion pune dhe aktivitet fitimprurës. Fillimisht e kam nisur me tre familje bletësh. Me pas fillova duke e shtuar, arrita deri në 600 familje bletësh, gjithësej janë 5 parqe.”

Për të siguruar mjalt cilësor bletërritësi 60 vjeçar është gjithnjë në kërkim të kullotave më të mira duke filluar që nga Elbasani, Dibra, Korca e Pogradeci.

shumëlulesh në fshatin Klenjë, për cdo vit në parkun e bletëve tërheq një visitor që nuk është i mirëpritur nga bletërritësi.

“Nga aroma që ka mjalti, ne këtu kemi një vizitor ai është

cilat ariu i ka frikë dhe largohet. Përse vjen ariu? Ai vjen për të ngrënë mjalt, i demton me gurë, thyen kosherën dhe pastaj ha mjaltin.”

Rifani thotë se është me fat që dashurinë për bletët ka ar-



ariu. Vitin e parë ariu na ka sulmuar 3 familje bletësh, vitin e dytë 12 familje bletësh, vitin

ritur ta përcjellë tek djemtë dhe nipi i tij.

“Këtë jemi munduar trashigimi femijëve, duke i dhënë pasion të gjithëve.”

Dita e vjeljes së mjaltit shënohet si momenti më i rëndësishëm për bletërritësit.

“Sot do të fillojmë me vjeljen e mjaltit. Fillojmë e nxjerrim hojtë dhe me pas i cojmë në dhomen e vjeljes. Kjo është kurniza që është vulo-sur 100% do të thotë që mjalti është i maturuar është i pjekur. Këtu jemi në ambientin e vjeljes temperatura duhet të jetë mbi 20 gradë celcius që mjalti të dalë dhe honet të mos demtohen. Me pas i zhvulosim me thike ose pirun, me pasi fusim në centrifugë.”

Për njerëz si Rifani, tregu nuk është problem, pasi është cilësia e mjaltit ajo që garanton klientin.



“Jemi në Zonën e Shebenikut, fshati Klenjë. Në një zonë mbi 1800 metra mbi nivelin e detit. Mjalt poriforol, shumëlulesh.”

Aroma e fuqishme e mjaltit

e tretë dy familje bletësh. Për tu mbrojtur nga demtimet e tij ne kemi bërë gardhin me tel me gjemba dhe kemi vendosur disa llamarina që bëjnë zhurmë nga era, te cilat japin tingëltime të

Agroturizmi rrit interesin për bujqësinë autoktone, banka shqiptare ruan 4500 lloje kultivarësh

Zhvillimi i njësive të agroturizmit në vendin tonë dhe pasioni për bujqësinë organike po rrit interesin për përdorimin e disa farave au-

ranës, i angazhuar për gati 40 vjet në studime dhe kërkime intensive për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike bi-

për shkak të klimës dhe kushteve gjeografike ka bankën e farave dhe fidanëve autoktone më të pasurën në Rajon me rreth 4500 kultivarë.

Ai shpjegoi se vit pas vit po rritet numri i personave që interesohen të kenë në kopshtet e tyre individuale ose në fermat e tyre të agroturizmit kultivarët e vjetër autoktonë. Zhvillimi i tyre do të ishte një biznes në fitim në një kohë kur tregjet globale po orientohen gjithnjë e më shumë nga prodhime autoktone organike. Por nga ana tjetër shumë nga kultivarët po shkojnë drejt zhdukjes për shkak të braktisjes masive të zonave rurale.

Profesor Jani vitin e kaluar ka dokumentuar një seri kultivarësh autoktonë në Alpet e

(Vijon në faqen 10)



toktone me origjinë qindra vjeçare.

Sokrat Jani profesor në Universitetin Bujqësor të Ti-

more autoktone tha se, zhvillimi i agroturizmit po nxit përdorimin e farave të vjetra shqiptare. Ai tha se, Shqipëria

Cilat janë produktet që mund të zhduken në Shqipëri si pasojë e ndryshimeve klimatike?

Të korrrat nuk kanë qenë aq të mbara për shkak të rritjes së temperaturave, specieve invazive, kontaminimit të kulturave gjenetikut të modifikuara.

Ishte dukur pak e largët dhe abstrakte ideja se ndryshimet klimatike mund të preknin direkt xhepin e më tej, të rrezikonin edhe jetën. Për dekada me radhë, kjo temë rrotullohej në tavolina konventash, kongresesh, senatesh ndërkombëtare. Por viti 2021 shënoi pikën e kthesës kur alarmi i kuq u ngrit njëzëri në të gjithë botën nga një raport i Kombeve të Bashkuara.

Por ndryshimet e klimës janë shumë më shumë sesa kaq dhe ato kanë nisur të ndihen në tryezën e ushqimit të secilit prej nesh.

Ka nisur nga buka, kafeja, vaji e një sërë produktesh që po shtrenjtohen dhe sot, si shkak nga importuesit, lakohen ndryshimet klimatike. Prekja e zinxhirit ushqimor dhe rreziqet në horizont nga ndryshimet klimatike po rriten dhe Shqipëria nuk është një vend imun, përkundrazi është tek më të rrezikuarit. Ndaj nuk është kurrë vonë për reflektim, sado të vogla të jenë përmirësimet.

Cilat kultura po zhduken për shkak të ndryshimeve klimatike?

Studimi i Goettsch, i titulluar “Rreziku i zhdukjes së disa bimëve të egra të mesit të Amerikës” zbuloi se ndryshimet klimatike kanë ndikuar në zhdukjen e shumë bimëve të egra të kulturave popullore. Patatet, avokadot, vanilja, pambuku i egër, fasulet e egra, kungulli, speci i egër, banania, molla, kumbullat e thata dhe xhenxhefilin janë vetëm disa prej tyre. Varietetet autoktone të vaniljes në Amerikën Jug-

ore dhe Qendrore janë në një rrezik të madh zhdukje, ndërsa pambuku i egër është i dyti në listë, ndjekur nga avokado dhe patatet e egra.

Një studim i mëparshëm – i publikuar në Global Citizen – zbuloi se 40% e të gjithë kulturave ushqimore po përballen me një zhdukje të afërt, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të kushteve klimatike.

“Ndryshimet klimatike kërcënojnë ‘të shpërthejnë’ kushte meteorologjike, parazitë dhe sëmundje, të cilat kulturat tona do t’i kenë të vështirë të përballen – lexo-

mala, El Salvador dhe Honduras, të cilat që të gjitha janë bërë të rëndësishme në dietat dhe në ekonominë e botës. Studimi zbuloi se shumë prej tyre janë duke u zhdukur, për shkak të mbiprodhimit dhe përdorimit të pesticideve. Të korrrat nuk kanë qenë aq të mbara për shkak të rritjes së temperaturave, specieve invazive, kontaminimit të kulturave gjenetikut të modifikuara, shpyllëzimit, thatësirave dhe zjarreve.

Nëse diçka nuk ndryshon shpejt nga këndvështrimi klimatik, kafeja e mëngjesit, gota e verës apo çokollata që hani



het në raport. – Nëse njerëzi do të jetojnë në të ardhmen, duhet t’i bëjmë sistemet tona të prodhimit të ushqimeve më të larmishme, elastike dhe të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore”.

Në ç’mënyrë, ndryshimet klimatike po i çojnë këto kultura drejt zhdukjes?

Raporti studioi 224 specie që rriten në Meksikë, Guate-

natën vonë mund të mos jenë më në duart tuaja për shkak të efekteve shkatërruese të ndryshimeve klimatike. Por gjëja më e rëndësishme është se kjo ka filluar të godasë komunitetet me të ardhura të ulëta, veçanërisht ato që mbështeten në bujqësi për sigurinë ushqimore dhe ekonominë. Rezultati përfundimtar mund të jetë me të vërtetë katastrofik.

Gazetari dhe autori i emisionit ‘Gjurmët’, Lorenc Shehu nderohet me medalje nga lideri i AAK-së Ramush Haradinaj



Gazetari dhe autori i emisionit ‘Gjurmët’, Lorenc Shehu i është dhënë nga ish-kryeministri i Kosovës dhe lideri i AAK-së, Z. Ramush Haradinaj, medalja “Me besim në ZOT, Atdhe e Shtet”. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, Z. Ramush Haradinaj pas dorëzimit të medaljes së nderit lexoi dhe motivacionin e dhënies së kësaj dekorate si më poshtë:

Motivacioni: Për të shprehur mirënjohjen time të thellë

për kontributin e veçantë dhe meritat e jashtëzakonshme në avancimin e çështjes sonë

sionin e tij ‘Gjurmët’ duke udhëtuar nëpër trevat shqiptare dhe në vende të ndryshme të



kombëtare kam nderin t’u ndajë Medaljen, “Me besim në ZOT, Atdhe e Shtet”.

Ky vlerësim vjen pas një kontributi prej 11 vitesh që jep gazetari Lorenc Shehu me emi-

europë ku punojnë dhe jetojnë shqiptarët. Gazetari Lorenc Shehu gjithashtu kontribuon edhe si gazetar i lajmeve në shumë media televizive në vend prej 25 vitesh.

Disa sfida të zhvillimit të blegtorisë në vendin tonë

Blegtoria zë rreth 48% të prodhimit bujqësor të vendit tonë. Përvec rëndësisë së madhe që ka bujqësia në tërësi në ekonominë e vendit (rreth



22% të PPB) dhe në punësim (rreth 39 % e forcave aktive të punës), ky sektor ka edhe një rëndësi strategjike për vendin, sepse bujqësia dhe blegtoria prodhojnë ushqimin për popullatën. Agresioni rus në Ukrainë ka sjellë shumë sfida të reja për bujqësinë në Europë e më gjërë, përfshirë edhe vendin tonë për sa i takon politikave dhe prioritetet e zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë. Nga ana tjetër, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë i shërben direkt zhvillimit harmonik të rajoneve të vendit tonë, zhvillimit të zonave rurale, si dhe frenimit të largimit të popullatës, sidomos të rinjve, prej tyre.

Blegtoria e vendit tonë ka një strukturë në të cilën mbizotërojnë ripërtypësit (gjedhi dhe bagëtitë e imta) zënë rreth 80 %, që mbarështohen kryesisht në fermat të vogla familjare (rreth 80 % e fermave), ndërkohë që fermat e mesme dhe të mëdha zënë rreth 20 % të fermave. Në dekadën e fundit evidentohet një prirje e uljes së numrit të krerëve, por e shoqëruar me një rritje të madhësisë së fermës, e cila është ende e dobët. Madhësia mesatare e sipërfaqes së tokës së fermave tona luhet nga 0,8 deri 1,26 ha me një numër mesatar krerësh 1,5 – 3 krerë gjedh, 10 -15 krerë dhen dhe 4 – 8 krerë dhi. Speciet e shpendëve dhe të dërrit zënë akoma më pak se 20 % në strukturën e saj.

Shqipëria ka kushtet ideale agroklimatike dhe resurse të mëdha natyrore për zhvillimin e blegtorisë. Kushtet e favorshme agroklimatike, toka me pjellori të lartë, resurset e konsiderueshme natyrore (sidomos fondi kullor i vendit) mundësojnë një prodhim shumë më të madh blegtoral se sa ai që realizohet aktualisht. Vendi ynë ka gjithashtu një traditë të vyer në zhvillimin e blegtorisë, sidomos të bagëtitë e imta. Ekonomisti agrar Dr. Zavalani, në disertacionin e tij, në vitin 1938, e karakterizon bujqësinë shqiptare të mbizotëruar nga blegtoria e imët, duke e bërë vendin tonë vend eksportues të disa prodhimeve

Arsimi i lartë Dual në shkencat zooteknike i paraprin modernizimit të blegtorisë në vendin tonë

Prof. Dr. Myqerem Tafaj
Universiteti Bujqësor i Tiranës

blegtorisë (sidomos emisioni i metanit, dyoksidit të karbonit dhe të lëndëve të pashfrytëzuara, sidomos P, N, dhe K në tokë).

Rritja e produktivitetit dhe prodhimit blegtoral ballafaqohet jo vetëm me sfida strukturore të madhësisë së fermës, nivelin e ulët të investimit dhe të mbështetjes financiare të sektorit të blegtorisë, nivelin ende të ulët të teknologjisë që aplikohet, por edhe me një sfidë tjetër, ndoshta edhe më të rëndësishme. Është fjala për nivelin bashkëkohor të Dijes dhe të burimeve njerëzore të mirëshkolluara.

Mbi tregun e punës të lidhur me sektorin e blegtorisë

Tregu i punës i këtij sektori për të shkolluarit në zooteknikë është ende i pazhvilluar plotësisht, në gjërësinë e tij, dhe i pakonsoliduar, për shkak të mosvlerësimit të rolit të tyre në zhvillimin e sektorit, si dhe deformimeve të tjera të mëdha të tij, edhe për shkaqe subjektive. Por rritja e produktivitetit dhe prodhimit blegtoral, diversifikimi i tij, rritja e kërkesave dhe standarteve për cilësinë dhe sigurinë e produkteve blegtorale, rritja e kërkesave për uljen e ndikimeve negative në mjedis dhe integrimi i bujqësisë e blegtorisë me ekonominë e gjelbër neutrale ndaj mjedisit, Green economy, përfarimi i sektorit me standartet e BE, do të cojnë në zgjerimin e tregut të punës të lidhur me blegtorinë dhe cilësinë e sigurinë e prodhimit të produkteve blegtorale, si dhe në rritjen e kërkesës së tij për të rinj të mirëshkolluar, sidomos në shkencat zooteknike dhe veterinarë, që zotërojnë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës të perspektivës të lidhur me këtë sektor.

Hapja e negociatave dhe përparimi i vazhdueshëm i Shqipërisë në rrugën e Integritetit në BE e rrit rëndësinë e blegtorisë për prodhimin e produkteve blegtorale si ushqime shtazore cilësore dhe të sigurta për konsumatorët, si dhe zgjeron ndjeshëm tregun e punës të lidhur me këtë sektor. Kjo nënkupton një rritje të ndjeshme të nevojës për specialistë dhe ekspertë të diplomuar në shkencat zooteknike, të cilët do të punojnë në agjencitë, drejtoritë dhe inspektoriatet shtetërore, rajonale dhe bashkiake, në shërbimin këshillimor, në industri, fabrika të ushqimeve e kompanitë e huaja dhe të vendit të ushqimeve për blegtorinë, banka, laboratorë të ushqimeve dhe shumë sektorë të tjerë. Dhe, meqë jemi në këtë pike, më duhet të nënvizoj një zhvillim

tejet regresiv që ka haset aktualisht në vendin tonë, madje edhe në nivelet vendimarrjes e të manaxhimit të sektorit. Fatkeqësisht, shpesh konsiderohet se mjekët veterinerë mjaftojnë për t'a zhvilluar sektorin e blegtorisë. Kjo do të thotë të mos bësh dot dallimin midis këtyre profesioneve, por edhe të mos diferencosh dot nevojat e sektorit për profesionistë me aftësi e kompetencat e nevojshme. Këto dy profesione rrjedhin nga shkencat të vecanta por të përafërta, përkatësisht shkencat zooteknike dhe ato veterinarë. Madje, gjatë 3 - 4 dekadave të fundit, ato, krahas thellimit, edhe po profilohehen dhe po ndryshojnë më shumë midis tyre. Shkencat veterinarë po zhvillohen gjithnjë e më shumë si shkencat mjekësore, me fokus profilaksinë, shëndetin publik veterinar dhe klinikën veterinarë. Këto prirje përvijon edhe formimi i mjekëve veterinar në vendin tonë. Ndërkohë, teknologjitë dhe bioteknologjitë e rritjes, të të ushqyerit dhe prodhimit e përpunimit të ushqimeve për kafshët, mbajtjes, përmirësimit racor, riprodhimit, cilësia e produkteve blegtorale primare (deri tek pragu i fermës, pa hyrë në përpunim industrial), mekanizimi, automatizimi e digjitalizimi i fermës, si dhe ekonomia dhe manaxhimi i fermës janë objekt i shkencave zooteknike dhe i profesionit të zooteknikut. Të mendosh se mund të zhvillohet një fermë blegtorale pa asistencën profesionale të zooteknikut është njësoj sikur të mendosh se një fermë që prodhon drithëra, perime apo fruta mund të zhvillohet pa asistencën profesionale të agronomit! E thënë ndryshe Zootekniku është "Agronomi i fermës blegtorale".

Çfarë aftësish kërkon tregu i punës nga të diplomuarit?

Pra, duket se tregu privat dhe publik i punës i lidhur me zhvillimin e blegtorinës, prodhimin dhe sigurinë e produkteve blegtorale në vendin tonë, ka nevoja reale për profesionistë të mirëshkolluar. Aq më tepër, nga një vështrim në këtë sektor, rezulton se moshë mesatare e specialistëve, të punësuar jo vetëm në sektorin privat por edhe në atë publik (agjencitë dhe drejtoritë rajonale dhe ato bashkiake, etj) është e lartë dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre përfundojnë kohën aktive të punës brenda kësaj dekade.

Por pyetja është: çfarë pritshmërie ka ky treg pune, në kuptimin e aftësive dhe kompetencave të profesionistëve të rinj? Dhe prej saj rrjedh

edhe pyetja tjetër: Si duhet të realizohen këto aftësi dhe kompetenca në programet e studimeve universitare?

Për t'iu përgjigjur këtyre dy sfidave të përgatitjes së specialistëve të rinj të zooteknisë, Universiteti Bujqësor (UBT) po zhvillon një projekt në kuadër të Programit Erasmus plus të Bashkimit Europian, në bashkëpunim me dy universitete perëndimore, Universitat für Wirtschaft und Umwelt Nürtingen, Gjermani, dhe University of Applied Sciences, Savonia, Finlandë, si dhe me Universitetin e Korçës, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Mitrovicës, institucione publike të bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, Qendra e Transferimit të Teknologjive (QTTB) – Korçë dhe Agjencia e Ushqimit & Veterinarisë - Prishtinë, si dhe disa shoqatat të prodhuesve si dhe organizatat të tjera që kontribuojnë në këtë sektor (Qendra e Zhvillimit të Blegtorisë, Tiranë; Nucleus-Albania, Tiranë, AGRINET-Korçë, Shoqata e Prodhuesve dhe Përpunuesve të Qumështit – Prishtinë) si partnerë të tregut të punës (Work Life Partner – WLP).

Për të studjuar pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës për specialistët e rinj, u zhvilluan një studim i tregut të punës (Survey), në të cilin u intervistuan rreth 150 fermerë dhe përfaqësues të organizatave të fermave dhe bizneseve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë nga Shqipëria dhe Kosova. Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe një kontribut të spikatur në angazhimin e fermerëve dhe përfaqësuesve të tjerë në këtë studim të tregut të punës. Gjithashtu, në këtë studim u intervistuan 147 specialistë dhe ekspertë të institucioneve publike qendrore dhe rajonale, përgjegjëse për politikëbërjen, manaxhimin dhe shërbimin këshillimor (Agjencitë Rajonale të Ekstensionit, Agropikat, Drejtoritë e Sigurisë ushqimore, etj) në Shqipëri dhe Kosovë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri dhe një ndihmesë të madhe në angazhimin e institucioneve të saj në këtë studim. Më tej, në këtë studim u intervistuan edhe 267 studentë dhe pedagogë të departamenteve përkatëse të UBT dhe universiteteve të tjera të Shqipërisë e Kosovës partnere në këtë studim.

Pritshmëritë e tregut të punës për specialistët e rinj në fushën e blegtorisë

Nga ky studim i tregut të punës rezultuan disa pritshmëri të qarta të punëdhënësve për formimin e specialistëve të

rinj të zooteknisë dhe agrobiznesit. Më kryesoret prej tyre janë përmbledhur më poshtë:

Formim solid profesional teorik dhe praktik. Në këtë grup janë studjuar aftësitë në njohjen dhe aplikimin e teknologjive në prodhimin bujqësor dhe blegtoral, mekanizimin dhe automatizimin, transportin dhe ndërtimin kryesish në fermat blegtorale.

Rreth 70% e të anketuarve nga sektori privat dhe ai publik e vlerësojnë formimin profesional teorik dhe praktik të specialistëve të punësuar deri në mesatar dhe shprehin një pritshmëri shumë më të madhe për një formim solid teknik profesional, teorik dhe praktik.

Aftësim praktik profesional i studentëve përmes praktikave të gjata gjata studimeve në ferma/biznese dhe institucionet publike të sistemit të bujqësisë. Është për tu nënvizuar pritshmëria shumë më e madhe për një formim shumë më të mirë praktik të specialistëve të rinj. Për ta vlerësuar më mirë këtë formim, është kërkuar vlerësim për aspektet konkrete që realizojnë atë, si praktika profesionale në ferma/biznese gjatë studimeve universitare, brenda dhe jashtë vendit, trajnimi i vazhduar gjatë punës, pjesëmarrja në aktivitetet që zhvillojnë organizatat e ndryshme në këtë fushë. Rreth 79 % e të anketuarve të sektorit privat dhe 91 - 94 % e atyre të sektorit publik vlerësojnë praktikën profesionale direkt në ferma/biznese "të rëndësishme" deri "shumë të rëndësishme" (skala 3 -5 nga 5 shkallë) për aftësimin e studentëve si dhe trajnimin e vazhduar gjatë ushtrimit të profesionit. Si punëdhënësit e sektorit privat, ashtu edhe ata të sektorit publik, i vënë rëndësi të madhe aftësimit praktik të aplikantëve në punësim, praktikës profesionale gjatë studimeve si dhe përvijës së fituar nga studentët në një universitet të huaj.

Fermat/bizneset dhe sektori publik janë të gatshëm të kontribuojnë në aftësimin praktik të studentëve. Si punëdhënësit e sektorit privat ashtu edhe ata të sektorit publik të sistemit të bujqësisë, vlerësojnë si „të rëndësishme“ deri „shumë të rëndësishme“ (skala 3.5 – 3,7 nga 5, vlera e medianës 4,0) angazhimin e tyre në realizimin e praktikave profesionale në bashkëpunim me universitetin, si faktor kyç për rritjen e nivelit teorik dhe praktik të të diplomuarve. Nga ana tjetër, me të njëjtë shkallë (mediana 4,0), ata vlerësojnë edhe rolin/mbështetjen e shtetit për bashkëpunimin midis universitetit dhe punëdhënësve në realizimin e praktikave duale të studentëve.

Aftësim në ekonominë dhe administrimin e sipërmarrjes dhe në këshillim. Punëdhënësit



SHOQATAT ANËTARE



KËSHILLAT RAJONALE



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



FED invest, FAKTOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK

NJË RRUGËTIM I GJATË SË BASHKU



Mbi **82.000**
Anëtarë



62
Degë

Agroturizmi rrit interesin për bujqësinë autoktone, banka shqiptare ruan 4500 lloje kultivarësh

(Vijon nga faqja 6)

Veriut. Sipas tij alpet shqiptare janë unike, për shkak të kushteve të ndryshme mjedisore të shkaktuara nga pozicioni i tyre gjeografik dhe ekologjia malore, distancat mes fshatrave dhe autonomia kulturore e popullsisë që jeton atje. Këto kritere, të kombinuara me një histori të pasur bu-

(Vijon nga faqja 7)

kanë vlerësuar me skala 2,6 – 3,6 nga 5 rëndësinë e këtyre aftësive për të diplomuarit, cka tregon një shkallë të lartë të pritshmërisë së tregut të punës.

Aftësi dixhitale dhe aftësitë e “ekonomisë së re” ose “New economy skills” janë vlerësuar me vlera mbi mesatare deri të larta (skala 2,8 – 3,4, nga 1 deri 5, mediana 3 nga 4)) nga punëdhënësit, ku ata të sektorit publik i rankojnë më mirë. Ndër këto aftësi punëdhënësit kanë vlerësuar: programet computerike që përdoren në manaxhimin e fermave/bizneseve, njohuritë e thelluara në IT, njohuritë e thelluara në digjitalizimin në sektor. Kjo tregon se, jo vetëm institucionet shtetërore por edhe fermat e mëdha dhe bizneset e sektorit të blegtorisë, janë të vetdijshëm dhe të mirëinformuar për zhvillimin e vullshëm të digjitalizimit në këtë sektor dhe presin një aftësim shumë të mirë të studentëve dhe specialistëve të rinj.

Aftësitë komunikuese dhe njohja e gjuhëve të huaja janë rankuar me skala 2,9 deri 3,3 nga 5 dhe një median 3 nga 4, cka tregon shkallën e lartë të pritshmërisë së punëdhënësve për aftësitë e të punësuarve në komunikim dhe në gjuhë të huaj. Ata vlerësojnë në mënyrë të vecantë zotërimin e gjuhës së huaj, shkrimin e raporteve dhe dokumenteve të ndryshme, idetë kreative në diskutime dhe në komunikimin me shkrim, si dhe kompetencat në komunikimin zyrtar online.

Aftësi të mira ndërpersonale (interpersonal skills) janë vlerësuar nga punëdhënësit e të dy sektorëve me skala mbi mesatare dhe të lartë (3,0 deri 3,9 nga 5, me një median 3,0 deri 4,0 nga 4,0; vlerat më të larta të skalës arrijnë 3,7 – 3,9 nga 5 dhe median 4,0 nga 4,0). Ata kanë vlerësuar sidomos aftësinë për punë në grup, personalitetin dhe sjelljen pozitive, besimin në vetvete, aftësinë për të zgjidhur situata më të vështira në punë, aftësinë për të përfunduar detyrat në kohë/afate, si dhe lojalitetin ndaj firmës, biznesit apo institucionit.

jqësore dhe vazhdimësinë e traditës shtëpi-kopsht, e bëjnë atë një zonë me agrobiodiversitet të lartë. Vitin e kaluar u gjetën dhe dokumentuam 76 varietete vendase që janë ende në rritje.

Në shumicën e varieteteve tradicionale të mbledhura që u rritën dhe u shërbyen nga kopshtarët, fasulet ishin më të shumtat dhe më pas kun-

gujt, lakrat, domatet dhe specat.

Zakonisht vetëm 1-3 fermerë në një komunitet kanë ruajtur një numër të konsiderueshëm të tokave tradicionale dhe se shumë komunitete i kanë humbur ato.

Por, rënia e popullsisë që merret me veprimtari bujqësore në zonat rurale, për shkak të migrimit, e kombinuar me

mungesën e vazhdimësisë kulturore në traditat e ruajtjes së farës kërcënon aftësinë e komuniteteve për të ruajtur agrobiodiversitetin.

Banka shqiptare gjenetike e farave dhe fidanëve disponon mijëra lloje shekullore, por kultivimi i tyre mund të rritestonte përshtatjen e tyre me kushtet e reja të klimës dhe përmirësimin e tyre në vazhdimësi.

Arsimi i lartë Dual në shkencat zooteknike i paraprin modernizimit të blegtorisë në vendin tonë

Arsimi Dual formon specialistë me aftësi dhe kualifikime që i përgjigjen kërkesave të modernizimit të blegtorisë në vendin tonë

Siç u trajtua më lart, zhvillimi i Dijes dhe burimeve njerëzore të mirëshkolluara është një sfidë shumë e rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit të blegtorisë dhe duhet t’i përgjigjet pritshmërive të zhvillimit të tij dhe tregut të punës të lidhur me të. Pra, vijmë tek pyetja e shtruar më sipër: *Si duhet të realizohen këto aftësi dhe kompetenca në programet e studimeve universitare? Ose, e thënë ndryshe, cili model i studimeve universitare i përgatit studentët me këto aftësi dhe kompetenca?*

Arsimi i kombinuar me praktikën (i njohur në gjermanisht me emërtimin “Duale berufliche Bildung”, dhe i përhapur në Europë zakonisht me emërtimin “Dual”) është një model shumë i suksesshëm arsimimi edhe në arsimin e lartë në shkencat bujqësore. Ky model origjinet nga arsimi i mesëm profesional. Në vitet 60-të ky model filloi të aplikohet edhe në arsimin e lartë, përkatesisht në shkollat të lartë të tipit “Berufsakademie” - Akademitë profesionale. Modeli i studimeve universitare Duale realizon më mirë ndërlidhjen e studimeve teorike në auditor me praktikën. Në arsimin e lartë Dual në shkencat bujqësore, formimi universitar është rezultat i kombinimit, thuajse në mënyrë të barabartë, i formimit teorik në klasë me atë praktik direkt në jetën reale të praktikës, fermës, biznesit. Ky model i arsimit të lartë universitar origjinet dhe është më i zhvilluar në Gjermani, por ai është i përhapur edhe në shumë vende të tjera europiane, si Austria, Zvicra, Finlanda, Holanda, Danimarka, Sllovenia, etj, nganjëherë me disa përshtatje që nuk prekin folozofinë e modelit.

Studimet universitare Duale kanë përparësitë të shumta

krahasuar me formën e zakonshme ose klasike të studimeve universitare që zbatohen edhe në vendin tonë. Përparësitë kryesore janë: (i) nivel i lartë profesional, praktik dhe teorik; (ii) punësim i menjëhershëm i të diplomuarve pas përfundimit të studimeve; (iii) familjarizim i studentëve me profesionin që herët gjatë studimeve, dhe (iv) aftësim për krijimin e sipërmarrjeve të reja. Këto përparësi të modelit Dual i përgjigjen më së miri aftësive që kërkon tregu i punës nga të diplomuarit dhe u përshkruan përmbledhtazi më lart.

UBT zhvilloi në bashkëpunim me Universitetin Nürtingen, Gjermani dhe Universitetin Savonia, Finlandë, në kuadër të projektit Erasmus të përmenduar më lart, dhe afron në këtë vit akademik programet universitare, sipas sistemit Dual, në shkencat zooteknike. Programi Bachelor Dual është konceptuar si formim universitar duke kombinuar Teorinë në auditor (4 simestra ose 2 vite akademike Teori) me praktikë profesionale të gjatë në ferma/biznese/institucione (2 simestra, përkatesisht simestrat 4 dhe 6 të studimeve Bachelor), pra 2 vite akademike teori + 1 vit akademik praktikë profesionale. Diplomati e studimeve universitare Duale në shkencat zooteknike janë plotësisht të njohura jashtë vendit, pa provime plotësuese, cka bëjnë që ato të mundësojnë një punësim më të shpejtë të të diplomuarve, jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë vendit. Projekti Erasmus që mbështet programin Bachelor Dual mundëson për studentët e shkencave zooteknike 1 simestr studime në universitetet e huaja partnere në projekt, përveç mobiliteteve që afron programi Erasmus për të gjithë studentët. Intershipi ose praktika e gjatë profesionale gjatë studimeve është e strukturuar sipas përvojave më të mira të universiteteve gjermane dhe finlandez. Ajo synon që studentët të mësojnë duke punuar vetë si dhe duke zhvilluar projekte inovative studimi individuale dhe në grup (format inovative të të mësuarit “Project-based Learning”

dhe “Indipendent Learning”), të udhëhequr nga specialistët e praktikës dhe pedagogët e UBT. Përmes praktikës së gjatë profesionale Duale në ferma/biznese/institucione, studentët familjarizohen plotësisht dhe shumë herët me profesionin. Studimet universitare Duale integrojnë edhe mësimin në Distançë dhe e-Learning, jo vetëm për pjesën teorike por edhe për diskutimin e projekteve që zhvillojnë studentët gjatë praktikës profesionale në ferma/biznese dhe institucione. Pjesa teorike e programit zhvillohet në laboratorë modern mësimorë shkencorë si dhe në auditorë të pajisur edhe me infrastrukturë moderne digjitale (Hybrid classroom) të Departamentit të Shkencave Zooteknike të UBT, të cilët u mundësojnë studentëve të dëgjojnë leksione në kohë reale edhe nga profesorë të universiteve partnere në projekt dhe universitete të tjera të huaja.

Pas studimeve Duale Bachelor, UBT afron programe Master për t’u thelluar në shkencat zooteknike dhe shkencat e tjera bujqësore. Këto shkencat po përjetojnë një "Revolucion" të vërtetë për shkak të zhvillimeve të shpejta në biologji molekulare, bioteknologji, mikrobiologji, biologji molekulare, kibernetikë biologjike, bioinformatikë, digjitalizim dhe teknologji informacioni, etj. Meqënëse synimi kryesor i një bujqësie dhe blegtorie moderne është prodhimi i ushqimeve cilësore dhe të sigurta për njeriun, të shkolluarit në shkencat zooteknike, agronomike dhe shkencat e tjera bujqësore njihen ndryshe edhe si "ekspertët e ushqimit në shkallë globale".

Zhvillimi i programit të studimeve universitare Duale në UBT, sipas modelit gjerman, u bë i mundur përmes mbështetjes së plotë të Dekanatit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Rektoratit të UBT, si dhe bashkëpunimit jo vetëm universiteve partnere nga Gjermania dhe Finlanda, por edhe me partnerë të shumtë të prodhimit, shumë ferma tona blegtorale të mëdha dhe të mesme, kompani të ushqij-

Peskaturizmi, diversifikim i ofertës turistike

(Vijon nga faqja 5)

Karavasta.

Aktualisht ka nisur një aksion pilot i realizuar në bashkëpunim me shoqatën e Peshkatarëve Artizanalë dhe menaxherëve të Parkut, që po ngjall shumë interes tek vizitorët.

Ekspertët shprehen se kjo iniciativë, mund të ofrojë të ardhura shtesë për peshka-

tarët, si dhe mund të sjellë një diversifikim të ofertës për operatorët turistikë, të cilët kanë një ndikim të qendrueshëm në burimet e peshkimit turistik.

Ekspertët ftojnë vizitorët ta provojnë këtë eksperiencë unike dhe të përjetojnë kulturën tradicionale të peshkimit si pjesë të turizmit të aventurës.

të aderojnë specialistët e sektorit public dhe privat, sipas formimit universitar, detyrave që kanë si dhe interesave të tyre profesionale. Këto Rrjete duhet të udhëhiqen nga departamentet e UBT. Rrjetet profesionale mund të hartojnë një plan konkrete trajnimi të vazhduar vjetor, i cili i përgjigjet problematikës konkrete që ndeshet në sektorin përkatës të bujqësisë në vendin tonë, si dhe mund të ndërmarrin veprimtari të tjera (demostrime praktikash të reja në prodhim, botime divulgative, ëorkshope tematike, etj.).

Studentët tanë që do të studjojnë në programet Duale të Zooteknisë do të jenë “ura lidhëse” midis universitetit, praktikisht profesorit të tij me praktikën. Ata do të mësojnë duke punuar cdo ditë me fermerët dhe specialistët e praktikës, të cilët do të jenë edhe bashkëudhëheqës të praktikës dhe vlerësuesit e parë të rezultatit të studentit në praktikën duale. Gjithashtu, specialistët e prodhimit dhe agjencive të sistemit të bujqësisë do të jenë bashkëudhëheqës në realizimin e projekteve të studentëve për probleme konkrete të fermës, si dhe të tezave të Bachelorit. Më tej, UBT do t’u afrojo partnerëve të prodhimit edhe asistencë profesionale si dhe shërbime të tjera, si analiza të ndryshme që nga toka, produktet blegtorale dhe ushqimet e kafshëve, etj.

Hapja e studimeve universitare Duale në fushën e zooteknisë në UBT dhe atë të agrobiznesit në Universitetin e Korçës, mund të jetë një shtysë edhe për zhvillimin e këtij modeli në arsimin e mesëm profesional bujqësor dhe zooveterinar, ku po implementohet aktualisht një projekt pilot me mbështetjen kryesisht të projektit të arsimit profesional të Konfederatës Helvetike. Zhvillimi i mëtejshëm i arsimit të mesëm Dual në shkollat e mesme profesionale dhe atij të lartë në UBT dhe në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Korçës, do të cojë në zhvillimin gradual të të gjithë Sistemit të Arsimit Dual në vendin tonë. Përvoja e Gjermanisë, Austrisë, Zvicrës në arsimin Dual të mesëm dhe të lartë, mund të na shërbej shumë edhe ne në zhvillimin e këtij modeli në vendin tonë.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Si të përmirësojmë të ushqyerit e gjedhit të qumështit, kur familja mban deri në 5 krerë gjedhë. Gjatë periudhës së dimrit, ushqimet e disponueshme janë kashta e grurit ose e misrit së bashku me barin e thatë dhe ushqimin e koncentruar. Një sasi minimale ushqimi e njomë (gjelbër) është esenciale për të siguruar funksionimin normal të plëndësit të gjedhi. Për këtë, duhet të mbështetemi në bimët foragjere që janë karakteristike për periudhën e dimrit ose ushqimet e silazhuara. Për fermerët e fermave të vogla familjare me kapacitet prodhimi të kufizuar, gjetja e ushqimeve të mjaftueshme në muajt e dimrit për të ruajtur një prodhim të mire të qumështit është gjithmonë një problem. Shumë prej tyre detyrohen të blejnë bar të thatë, koncentrat ose silazh për të ushqyer kafshët me çmime të larta, duke rritur kështu koston e prodhimit dhe për pasojë fitimet janë shumë të pakta. Prandaj, përgatitja e ushqimeve të silazhuara në kushtet e këtyre fermave është e nevojshme. Silazhi konsiderohet si mënyra më e mire për të konservuar bimët foragjere. Misri foragjer është bima që silazhohet më mire pasi është e pasur ne karbohidrate lehtësisht të tretshme. Për të pasur një silazh të cilësisë së mirë është e rëndësishme që përmbajtja e lëndës së thatë të bima që do të silazhohet duhet të jetë 30-35%.

Avantazhet:

- Ruhet vlera ushqyese e ushqimit për një periudhë të gjatë (deri 5 vjet);
- Bimët mund të korren në fazën optimale të zhvillimit dhe përdoren me efektivitet nga gjëja e gjallë.
- Humbjet në lëndë ushqyese janë më të pakta (nën 10%) krahasuar me humbjet standard në prodhimin e barit të thatë (30%);
- Përdorim më ekonomik i bimës me rendiment të lartë të masës së njomë;
- Përdorim më i mirë i tokës me 2-3 prodhime në vit;
- Silazhi prodhohet në çdo lloj moti;
- Fermentimi në silazh pakëson nitratat e dëmshme të akumuluar te bima gjatë thatësirës dhe në rastet kur në kulturën foragjere janë përdorur sasira të bollshme plehra kimike;
- Nënproduktet si kashta e misrit, etj. përmirësohen në shije, në vlerë ushqyese dhe përdoren në sasi më optimale;
- Kërkon 10 herë më pak hapësirë për t'u ruajtur krahasuar me barin e thatë;
- Silazhi i misrit ka 30-50% vlerë ushqyese më të lartë krahasuar me misrin kokërr dhe kashtën e misrit, 2 kg silazh misri (30% lëndë e thatë) ka vlerë ush-

PËRGATITJA E SILAZHIT MISËR KALLI NË FERMAT E VOGLA FAMILJARE

qyese të barabartë me 1 kg bar të thatë.

Disavantazhet:

- Silazhi nuk paraqet interes për tregtim meqenëse vlera e tij është e vështirë për t'u përcaktuar;
- Nuk lejon transportim në distance të gjata;
- Pesha rrit koston e manipulimit;
- Përmban shumë më pak vitamin D krahasuar me barin e thatë.



Foto nr. 1. Përgatitja e silazhit mbi sipërfaqe të tokës dhe në thasë plasmasi



Përgatitja e silazhit

Në korre qelizat e bimës nuk “vdesin” menjëherë, ato vazhdojnë frymarrjen në prani të ujit dhe oksigjenit. Oksigjeni është i nevojshëm për procesin fiziologjik të frymë-marrjes, i cili i siguron energji për aktivitetin jetësor të qelizës. Në këtë proces, karbohidratet konsumohen (oksidohen) nga qelizat e bimës në prani të oksigjenit për të prodhuar gaz karbonik, ujë dhe nxehtësi: Në silazh, enzima të caktuara, myqe dhe bakterie që ndodhen në mënyrë të natyrshme në bimët foragjere janë burime të rëndësishme respirimi. Kjo fazë duhet të jetë sa më e shkurtër me qëllim që të kufizojmë humbjet në vlerë ushqyese. Për të garantuar një silazh të cilësisë së mirë është e rëndësishme që bima të korret në fazën optimale, të përmbajë 30-35% lëndë të thatë, të sigurohet një ngjeshje e mire me qëllim largimin e ajrit, të mbulohet në mënyrë hermetike me plastmas dhe sipër plastmasit të hidhet dhe. I gjithë procesi nga fillimi deri në mbyllje të depos duhet të zgjasë 48-72 orë. Përqindja e lagështirës në pjesë të ndryshme të bimës së misrit si dhe momenti më optimal i korres paraqiten më poshtë. Rekomandohet që përmbajtja e lagështirës të bima të jetë 65-70% kur silazhi përgatitet në depo horizontale, 63-68% në silose vertikale dhe 65% për silazhin e përgatitur në thasë plastmasi.

Prodhimi dhe cilësia e silazhit misrit influencohet nga stadi i rritjes.

Vonesa në korre mund të ulë tretshmërinë e fibrës dhe amidonit, përmbajtja në ligninë rritet dhe kokrra bëhet më e fortë

Tab. nr 1. Përmbajtja e lëndës së thatë në pjesë të ndryshme të bimës së misrit në filli të fazes së dyllit

Pjesët e bimës	Përmbajtja në lëndë të thatë në fillim të fazës së dyllit (%)
Kokrra	33
Koçani	8
Gjethja	19
Kërçelli	24
Lëpushkat	8

foragjere. Silazhi misër kalli përbën një nga ushqimet bazë në të ushqyerit e lopëve të qumështit, veçanërisht të tufave të qumështit me prodhimtari të

lartë. Silazhi i misrit me përmbajtjen e tij relativisht të lartë në energji është mjaft mirë i përshtatshëm për t'u përdorur në racionet ushqimore me kosto të ulët për gjedhin në majmëri. Silazhi i misrit kërkon më pak fuqi punëtore për njësi peshe për t'u prodhuar se shumë kultura të tjera foragjere. Gjithashtu, kjo mund të riciklojë me efektivitet lëndët minerale, veçanërisht sasirat e mëdha të N-Azot dhe K-Kalium. Momenti më i përshtatshëm për korre është faza e dyllit. Bima duhet të korret 10-12 cm



Foto nr. 2. përgatitja e silazhit në fuçi plastike



dhe më pak e tretshme në qoftë se nuk copëtohet. Kur përmbajtja në lagështi e bimës është e lartë dhe madhësitë e copëzave të masës së grirë janë të mëdha atëhere një sasi më e madhe e acidit laktik nevojitet

nga toka. Copëzat e bimës misrit gjatë silazhimit duhet të kenë një gjatësi nga 1-3 cm, megjithëse gjatësia optimale varet nga faza e vegjetacionit siç tregohet më poshtë.

Tab. nr. 2. Lënda e thatë dhe gjatësia e pjesëzave në fazat e ndryshme të vegjetacionit

Faza	Lënda e thatë (%)	Gjatësia e pjesëzave (cm)
Qumësht	20-25	3-5
Qumësht-Dyll	26-30	1-3
Dyll	31-35	0.7-1

për të ulur pH. Përmbajtja më e lartë në lagështi ose në lëndë të thatë duhet të shmangët meqenëse aktiviteti i baktereve acido laktike ulet dhe aktiviteti i baktereve që prodhojnë acid butirik rritet. Sasia optimale e lëndës së thatë arrihet në fazën e fundit të vegjetacionit të bimës. Kultura e misrit kalli silazh prodhon më shumë energji për njësi sipërfaqe se çdo bimë tjetër

Përgatitja e silazhit në thasë plastmasi ose fuçi plastike

Kjo metodë konsiston në grirjen e masës së njomë në copëza me gjatësi 3 cm dhe mbushjen e thasëve të plastmasit ose fuçive plastike me masën e grirë. Masa e grirë presohet me qëllim largimin

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

PËRGATITJA E SILAZHIT MISËR KALLI NË FERMAT E VOGLA FAMILJARE

e ajrit dhe parandalimin e prishjes. Silazhi mund të ruhet në këtë mënyrë pa humbur vlerën ushqyese deri në 1 vit. Kjo bën të mundur që fermerët të sigurojnë një të ushqyer normal gjatë gjithë periudhës së dimrit e më tej. Qëllimi i grirjes dhe kompaktësimit të masës së grirë për silazh është:

- Të çlirohet sheqer sa më shumë të jetë e mundur për fermentim;
- Të sigurohemi që është larguar ajri nga masa e silazhuar me qëllim që të kemi një fermentim normal.

Masa e korrur duhet të grihet brenda 24 orëve, përndryshe mund të thahet ose të prishet. Një veçori e kësaj metode silazhimi është se kjo lejon konservimin e ushqimit në sasira të vogla për një periudhë të gjatë kohe. Kjo ndryshon nga teknika tradicionale e bërjes së silazhit, ku sasira të mëdha të bimës korren dhe grihen në të njëjtën kohë. Një familje fermeri mund të konservojë 2 thasë në ditë, e cila do të bënte të mundur që kafshët ti ushqente me silazh në periudhën e vjeshtës dhe dimrit. Gjithashtu mund të silazhohet e gjithë bima së bashku me kallirin ose pa kallirin ose gjethet mund të silazhohen veçantë.

Avantazhet:

- Përgatitja e silazhit në thasë plastike ose fuçi plastike është një alternative ekonomike krahas sistemeve tradicionale të konservimit ushqimit;
- Është një mënyrë efektive për ruajtjen e ushqimit me humbje minimale në lëndë ushqyese;
- Kjo metodë i mundëson fermerëve të sigurojnë silazh gjatë gjithë vitit. Thasët me silazh duhet të vendosen në një vend (sipërfaqe toke) të ngritur dhe të drenazhuar;
- Silazhi është plotësisht i mbyllur hermetikisht në thes. Kjo do të thotë që përmbajtja likuide e silazhit qëndron brenda në thes;
- Përgatitja e silazhit në thasë ose fuçi plastike shmang punën e vështirë të heqjes nga depo të sasisë ditore që do të konsumohet, transportin dhe shpërndarjen të kafshët;
- Për shkak se silazhi në thes konsumohet plotësisht brenda ditës, kjo do të thotë që nuk ekspozohet në ajër duke ruajtur kështu vlerat ushqyese, ndërsa shpeshherë vërehet që silazhi që hiqet nga depo për konsum ditor ekspozohet në ajër duke pësuar humbje në vlerë ushqyese;
- Thasët plastikë me silazh mund të depozitohen dhe të ç'vendosen lehtësht, kështu që çdo anëtar i familjes mund ta

transportojë atë për të ushqyer kafshët.

Disavantazhet:

- Rëndësia e kontrollit për të parandaluar dëmtimin e thesit;
- Mundësi kontaminimi kur hiqet nga thesi;
- Vështirësia në grirjen e masës së njomë, meqenëse masa e grirë në përmasa optimale garanton një cilësi më të mirë. Në rastin kur gjatësia e copëzave të grira është më e madhe se sa duhet, atëherë kjo vështirëson largimin e plotë të ajrit dhe mund të ndodhë shpuarja e thesit.

Me planifikim të kujdeshsëm, të gjitha këto mund të eliminohen. Humbjet mund të ndodhin për shkak të:

- Përmbajtjes në lëndë të thatë më të ulët ose më të lartë se 32%;
- Dëmtimit nga zogjtë ose insekte duke çuar në shpuarjen e thasëve dhe humbje në vlerë ushqyese të silazhit.

Depozitimi

Zgjedhja e një vendi të përshtatshëm për ruajtjen e thasëve është mjaft e rëndësishme. Ato duhet të ruhen sa më afër vendit ku mbahen kafshët dhe toka të jetë e drenazhuar. Mbajtja e thasëve në distancë nga ushqimet e tjera, mund të zvoglojnë dëmtimet nga zogjtë ose insektet. Megjithëse ruajtja në ambiente të hapta dhe mbulimi me plastmas për të parandaluar dëmtimin nga zogjtë, është ngandonjëherë më efektive. Sipërfaqja e zgjedhur për ruajtje (depozitim) të thasëve ka një impakt të madh në cilësinë e silazhit dhe lehtësi për transportimin dhe të ushqyerit e kafshëve.

Bazuar në përvojën që ekziston, vendi i ruajtjes paraqitet në disa tipe:

- Vend i shtruar me çimento, siguron vend të shkëlqyer për thasët me silazh, drenazhim të mire dhe transportimi kryhet lehtësisht, shmang minjtë dhe e bën shumë të lehtë inspektimin e thasëve të dëmtuar.
- Vend i asfaltuar. Më pak i kushtueshëm se çimento. Ka avantazhe pothuajse të njëjta si çimento dhe nuk ndikohet nga temperaturat e larta gjatë ditëve të nxehta të stinës së verës;
- Vendi i shtruar me zhavorr. I përshtatshëm për vendosjen e thasëve me silazh. Pengon rritjen e barishteve të këqija dhe veprimin e pesti-t. Meqenëse është

zhavorr, vështirëson pak transportimin;

- Vendosje direkt në tokë. Mund të jetë i përshtatshëm, vetëm në qoftë se është i drenazhuar. Duhet të kujdesimi për të mos lejuar zhvillimin e barit egër nëse ka kullim të mjaftueshëm larg qeseve. Gjithashtu duhet të kemi dhe një vend rezervë për të zhvendosur thasët me silazh në rastin kur moti është mjaft i lagësht (me shi), veçanërisht në stinën e pranverës.

Paketimi

Paketimi i thasëve me silazh është një proces mjaft i rëndësishëm pasi ndikon në cilësinë e silazhit. Prandaj është e rëndësishme të ndiqen rekomandimet e mëposhtme kur seleksionojmë thasët që do të përdoren:

- Thasët e plastmasit duhet të jenë të fortë dhe me kapacitet prej rreth 50 kg silazh;
- Cilësia e materialit (polietilenit) është mjaft e rëndësishme. Thesi mund të jetë dopio, pra të ketë një thes të brendshëm ku qëndron silazhi, përveç thesit të jashtëm i cili duhet të jetë më i trashë dhe i fortë që të mos dëmtohet;
- Të mos kenë ndonjë vrimë dhe mbyllja të jetë hermetike;
- Polietileni që përdoret për prodhimin e thasëve të plehrave kimike, është mjaft i përshtatshëm edhe për prodhimin e thasëve për përgatitjen e silazhit.

Mirëmbajtja

Për arsye të ndryshme (zogjtë, minjtë, kafshët, etj.) mund të ndodhë dëmtimi i thasëve dhe për pasojë futje të ajrit dhe prishje të silazhit. Për të mirëmbajtur thasët me silazh është e nevojshme të ndiqen rekomandimet e mëposhtme:

- Kontroll i vazhdueshëm i thasëve me silazh dhe në qoftë se konstatohet ndonjë dëmtim të riparohet; në qoftë se dëmtimi është i madh, atëherë duhet të futet në një thes tjetër (ripaketim) sa më shpejt të jetë e mundur;
- Nuk duhet lejuar kontakti i thasëve nga qentë, macet dhe kafshët e tjera;
- Të shënohet te thesi numri dhe data e përgatitjes së silazhit;
- Mos të lejohet hapja e thasëve me silazh gjatë natës;
- Në qoftëse thasët ruhen mirë atëherë i gjithë procesi i përgatitjes së silazhit (korja, fermentimi, etj.) zgjat 3-4 javë, pas 25 ditë silazhi është gati për t'u konsumuar

nga kafshët;

- Pas konsumit të silazhit, thasët bosh duhet të lahen, thahen dhe të ruhen në një vend të sigurtë për t'u përdorur për vitin tjetër.

Mbushja e thasëve me masën e grirë gjatë procesit të silazhimit

Gjatë përgatitjes së silazhit dhe mbushjes së thasëve me masën e grirë duhet të ndiqen këto rregulla:

- Masa e njomë që do të silazhohet të mos kontaminohet;
- Misri të korret kur përmbajtja e lagështirës të jetë 58-68%;
- Mbyllja hermetike e thasëve të mbushur me masën e grirë duhet të bëhet jo më vonë se 24 orë pas korrijës;
- Mbushja e thasëve me masën e grirë të bëhet në mënyrë uniforme dhe sa më shpejt të jetë e mundur. Çdo thes duhet të mbushet brenda 1 ore ose maksimumi 2 orësh. Kjo është e nevojshme për të ruajtur cilësinë e masës së grirë;
- Masa e grirë futet në thes duke e ngjeshur sa më fort të jetë e mundur (mund të përdoret pajisje presuese në madhësinë e diametrit të thesit ose në mungesë të saj, tokmak druri me qëllim që të eliminohet xhepat e ajrit që mund të krijohen në thes dhe të kemi një fermentim normal. Për këtë është e rëndësishme që gjatësia e copëzave të masës së grirë të jenë sa më të vogla. Kështu sigurohet një ngjeshje më e mirë dhe largimi plotësisht i ajrit;
- Gjatë mbushjes, paketimit, dhe mbylljes hermetike të thasëve të jemi të kujdesshëm që të mos i dëmtojmë.

Kontrolli i minjve

- Thasët me silazh, veçanërisht silazhi i misrit është ushqim mjaft tërheqës për minjtë. Këto të fundit mund të fshihen midis thasëve, duke i brejtur thasët plastikë dhe për pasojë kemi penetrim të ajrit brenda në silazh duke shkaktuar prishje të tij. Prandaj, është e nevojshme kontrolli i vazhdueshëm i thasëve;
- Kontrollimi thasëve për ndonjë dëmtim nga minjtë, zogjtë ose kafshët;
- Nuk duhet të përdorim kimikate kundër minjve dhe insekteve, meqenëse thasët mund të dëmtohen nga këto duke i bërë të papërdorshëm për herën tjetër;
- Thasët mund të vendosen në sergjene të ngritura (me këmbë) nga dyshemeja (toka) (me qëllim që mos të arrihen nga minjtë, macet, etj.

Përgatiti: Albi Shehu, Flamur Shabani

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

KENDI I EKSPERTIT

Pamja e qiellit gjatë muajit qusht 2022
































Më 12 gusht - Hëna e plotë,
Superhëna. Hëna do të jetë e
vendosur në anën e kundërt të

Kalendari bujqësor, muaji gusht 2022
























Përgatitur nga Prof. As. Dr. Egrem Mecollari

në 16°C, rrallë duke rënë nën 12°C ose duke kaluar 21°C. Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht varioi-

Parashikimi i motit për muajin qusht 2022 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	24	33	24-36-32	0	0	7	8	JL	VP	9	Plot me diell	
2	24	34	24-38-33	0	0	7	6	VL	V	9	Plot me diell	
3	23	34	27-38-33	0	0	6	7	VL	VP	9	Plot me diell	
4	24	33	25-38-34	0	0	4	7	JJL	VVP	9	Plot me diell	
5	24	33	23-38-33	0	0	6	11	VVL	VVP	9	Kryesisht me diell	
6	23	33	22-35-31	0	0	11	13	VVL	VVP	9	Plot me diell	
7	21	32	20-33-31	1	0.5	9	9	VL	VVL	9	Interval resh e diell me ndonjë stuhi me pika pasdite	
8	20	31	18-31-30	0	0	15	17	LVL	LVL	3	Diell dhe zona me re të ulta	
9	20	31	19-35-31	4.3	2	7	2	JL	JL	7	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi	
10	20	32	20-33-31	4.5	3	9	4	PJP	JP	4	Kohë me re dhe diell me disa stuhi	
11	20	31	19-32-29	0	0	9	7	JP	P	8	Pjesërisht me diell	
12	20	31	18-31-30	2	1	13	15	VP	VVL	8	Pjesërisht me diell me stuhi të rastit	
13	20	31	19-32-29	0	0	13	13	V	VVL	8	Plot me diell	
14	21	31	18-32-29	0	0	11	13	V	VL	8	Plot me diell	
15	21	31	19-34-30	0	0	9	13	VVL	VL	8	Plot me diell	
16	21	32	19-35-31	0	0	7	11	VVL	VL	8	Plot me diell	
17	22	34	20-36-33	0	0	6	11	VVL	VL	8	Plot me diell	
18	23	34	22-37-33	0	0	7	11	VL	VL	8	Plot me diell	
19	22	33	21-36-32	0	0	6	7	VVL	VVL	8	Plot me diell	
20	23	33	22-35-32	0	0	7	9	VVP	V	8	Plot me diell	
21	22	34	22-35-32	0	0	9	11	VVP	VVL	8	Plot me diell	
22	21	33	20-35-32	0	0	9	9	V	VVL	8	Plot me diell	
23	21	34	20-35-33	0	0	7	6	JP	JP	7	Shumë nxehtë me plot diell	
24	20	32	18-32-30	0	0	15	13	P	PVP	7	Plot me diell	
25	21	30	19-30-28	0	0	17	15	VP	V	7	Diell	
26	20	30	18-31-28	0	0	15	15	V	VVL	7	Plot me diell	
27	21	31	21-34-30	0	0	7	6	V	V	7	Kryesisht me diell	
28	21	31	20-32-29	0	0	9	11	VP	V	7	Pjesërisht me diell	
29	22	33	20-33-31	0	0	15	11	VVP	VVL	7	Plot me diell	
30	33	44	21-34-32	0	0	11	11	V	VL	7	Kryesisht me diell	
31	21	33	20-33-32	0	0	11	13	VVP	VVP	7	Kryesisht me diell dhe shumë e nxehtë	

Parashikimi i motit për qusht 2022 në Korçë (Zona e ftohtë)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	15	30	16-33-29	0	0	2	6	PJP	PVP	10	Shumë diell	
2	15	30	16-34-29	0	0	2	6	VVP	PVP	10	Plot me diell	
3	13	25	14-26-24	0	0	4	4	VL	V	3	Kohë me re dhe diell	
4	14	26	15-30-25	0	0	4	6	V	VVP	10	Pjesërisht me diell	
5	14	26	14-30-25	0	0	4	6	VVL	VL	9	Kryesisht me diell	
6	14	27	15-31-26	0	0	6	4	LVL	VL	9	Kryesisht me diell	
7	14	27	16-30-26	0	0	6	4	LVL	LVL	9	Kryesisht me diell	
8	15	27	16-31-26	0	0	4	4	V	V	9	Plot me diell	
9	14	28	15-31-27	0	0	4	6	PJP	VP	9	Kryesisht me diell	
10	15	29	25-33-28	0	0	2	6	VL	VVL	9	Kryesisht me diell	
11	15	30	15-32-29	0	0	6	6	VP	V	9	Kryesisht me diell	
12	12	30	13-32-29	3.3	1.5	4	4	VVL	VVL	8	Periudhë me diell me disa shira dhe stuhi,kryesisht vonë	
13	13	27	12/29/2025	0	0	7	9	VP	VVP	9	Kryesisht me diell	
14	13	27	10/29/2026	0	0	9	13	V	VVL	9	Kohë me diell dhe njolla resh	
15	13	28	10/29/2026	0	0	13	13	VL	VL	9	Kryesisht me diell	
16	14	27	14-30-26	0	0	7	7	VVL	VL	9	Diell	
17	15	29	13-32-28	0	0	7	9	VL	LVL	8	Kryesisht me diell	
18	15	29	14-32-28	0	0	9	9	LVL	LVL	8	Kryesisht me diell	
19	14	29	13-32-28	0	0	7	9	VL	LVL	8	Kohë me re dhe diell	
20	14	28	13-31-28	0	0	6	6	VL	LVL	8	Diell deri pjesërisht me re	
21	13	28	13-31-28	0	0	6	6	LVL	LVL	8	Kohë me re dhe diell	
22	13	28	14-28-28	0	0	4	2	VVP	VP	3	Diell dhe zona me re të ulta	
23	14	26	15-26-25	1	0.5	7	7	PVP	VP	4	Re dhe diell me ndonjë stuhi me pika pasdite	
24	13	28	15-29-27	0	0	7	6	PVP	VVP	8	Pjesërisht me diell	
25	14	26	15-27-25	0	0	6	6	PVP	PVP	3	Diell dhe zona me re të ulta	
26	12	27	11/29/2025	0	0	7	7	P	PVP	8	Periudhë me vranësira të ndrueshme	
27	14	28	15-29-27	0	0	11	7	PVP	VP	8	Pjesërisht me diell	
28	13	28	13-29-27	0	0	9	7	PVP	V	7	Diell duke shkuar në shtimin e reve	
29	10	26	8/26/2026	0	0	4	9	VP	VP	3	Kohë me re	
30	10	25	10/27/2024	4.4	3	4	4	JL	JL	7	Kohë me vranësira dhe diellme disa shira dhe stuhi	
31	11	26	10/30/2025	0	0	6	6	V	VL	7	Diell deri pjesërisht me re	

